



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
31.01.2024

Me datë 31.01.2024, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Jona Leqejza, Uarda Gjekaj, Hilmi Lakti, Bledianë Nika, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkoçaj, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Hedije Nasa, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Irena Shala, Artan Haxhi, Elmira Ndrevasaj, Gjenarin Kapcari, Irma Kopliku, Elis Doci, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkreli, Aleksander Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahim, Violeta Perndrecaj, Gjovalin Ndoj, Suada Kopshti, Blendi Gjylbegaj, Gloria Shllaku, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Amina Lici.

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit Z. Oltion Luli

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Dhjetor 2023".*
2. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin bregdetar të njësisë administrative Velipojë, Bashkia Shkodër".*
3. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e liqenit të Shkodrës, Bashkia Shkodër".*
4. Pr/ Vendim: *"Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të Këshilltarit bashkiak Z. Gjovalin Darragjati"*
5. Pr/ Vendim: *"Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të Këshilltarit bashkiak Z. Helga Sallaku"*
6. Pr/ Vendim: *"Për një ndryshim të pjesshëm të VKB nr.51 datë 14.04.2009 "Miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër", miratuar me VKM nr.421 datë 02.06.2010, të ndryshuar sipas lidhjes 1, të pronës me numër rendor 126, sipas formularit për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore".*

7. Pr/ Vendim: "Për miratimin e listës së përfiruesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk e përballojnë qiranë e tregut të lirë për vitin 2024"
8. Pr/ Vendim: "Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projektin Hold-on Nxitja e aneksit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë"
9. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Shtesë në rendin e ditës:

1. Pr/ Vendim: "Për miratimin në parim të vlerës së bashkëfinancimit dhe listës së përfituesve për realizimin e projektit "Rikonstruksion rrugët FERMENTIM"
2. Pr/ Vendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri"
3. Pr/ Vendim: "Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese , të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike"

Përpara se të vijohet me votimin e rendit të ditës, fjalën e merr Znj.Shala e cila shprehet se për vendimet shtesë koha për ti marr në shqyrtim ka qënë shumë e shkurtër dhe nuk e kuptojmë pse pr.vendimet vijnë me kaq vonesë, madje edhe pas mbledhjes së kryesisë së këshillit ku vendoset rendi i ditës. Megjithatë grupi politik BF është pro miratimit të tyre, pasi nga këto pr.vendime preken direkt qytetarët e Shkodrës, por dëshirojmë që kjo të shërbejë si një paralajmërim për herët e tjera, që pr.vendimet të na paraqiten në kohë për njohje dhe studim nga ana jonë.

Hidhet në votim rendi i ditës, ku rezultojnë 36 vota Pro,0 Kundër, 0Abstenim.

Vijohet me pikën e parë të rendit të ditës: Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Dhjetor 2023".

Relaton **Z.Malocaj**, drejtor në drejtorinë e ndihmës ekonomike në Bashkinë e Shkodrës sipas materialit të përgatitur nga administrata. Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 40 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën e 2. Dhe 3.të rendit të ditës: 1.Pr/ Vendim: "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin bregdetar të njësisë administrative Velipojë, Bashkia Shkodër".2. Pr/ Vendim: "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e liqenit të Shkodrës, Bashkia Shkodër".

Pika këto që do relatohen njëherazi dhe do votohen ndarazi. Nga ana e komisionit të Planifikimit, Zhvillimit të territorit fjalën e merr **Z.Sokoli** në cilësinë e kryetarit, i cili relaton

shkurtimisht mbi atë çfarë është diskutuar dhe vendosur në mbledhjen e këtij komisioni me sugjerimet dhe propozimet e tyre. Ai shton se Kushtet e komisionit për miratimin e këtij pr.vendimi kanë qënë për disa modifikime në hartë dhe shtesa të hapësirave publike por vërehet që këto ndryshime nuk janë pasqyruar.

Përgjigjet për këtë **Z.Bejleri**, duke thënë se është e vërtetë që modifikimet e kërkuara nuk janë bërë, pasi duhet të merret fillimisht verifikimi nga agjencia kombëtare e bregdetit nëse ka apo jo hapësirë të parashikuar për këtë.

Znj. Shala propozon që të bëhet një shpërndarje propocionale të hapësirave publike dhe atyre private. Vërejmë që në një pjesë të vijës bregdetare, ku nuk ka hotele por shtëpi pushimi të taksapaguesve të rregullt, të cilët nuk kanë dalje në plazh/hapësirë të dedikuara. Ploblem ky i shtruar edhe në mbledhjen e kryesisë dhe të komisionit.

Z.Bejleri shprehet se për zonën në fjalë ka hapësira publike të parashikuara, përkatësisht përballë rrugës 4 dhe 5.

Znj.Pode kërkon të dijë se si do bëhet dalja e pushuesve në hapësirat publike, direkt në bregdet apo pas plazheve private?

Sqaron **Z.Bejleri** se këtë vit aksesit do jetë direkt në bregun e detit, pra hapësirat publike do kenë të njëjtat kushte dhe hapësirë si ato private.

Fjalën e merr **Z.Behri** i cili shprehet se a është e mundur që ndërmjet hapësirave të lihet një “korridor” për dalje të mjeteve lundruese, në mënyrë që t’i shmangemi rrezikut për pushuesit.

Përsëri **Z.Bejleri** thotë se aktualisht janë parashikuar 3 korridore të tilla. Do shihet edhe fluksi i pushuesve, por për momentin këto janë parë si të mjaftueshme. Nese do ketë kërkesa të tjera do rishihet për shtesa.

Z.Bjanku shprehet se për korrektesë/seriozitet pr/vendimi duhet të ishte hartuar në bazë të emërtesave të caktuara në adresarin e ri të digjitalizuar. Ai shton se saktësisht tek zona pas plazhit Ada, ka një zonë të mbrojtur dhe a është marrë parasysh kjo gjë në shpërndarjen e këtyre hapësirave.

Z.Bejleri shprehet se përse i përket sistemit të adresave, nuk beson se ka lidhje me atë ç’ka shpreh ky pr/vendim. Por sqaron se këtë vit, parcelat do kenë një veçori, do jenë secila me 4 koordinatat gjeografike të sakta, lehtësisht të verifikueshme. Kurse në lidhje me pyetjen e dytë, bëhet fjalë për ndërhyrje në përmirsimin e shtigjeve ekzistuese, gjithmonë konform normave dhe rregullave të kërkuara për mjedisin dhe zonat e mbrojtura.

Z.Tafaj ka një pyetje në lidhje me sigurinë në plazh. A ka Bashkia ndonjë strategji për vrojtuesit e plazheve?

Përgjigjet **Z.Bejleri**, i cili thotë se për vrojtuesit e plazhit nuk ka strategji nga ana e Bashkisë, por ka detyrim ligjor që secila nga hapësirat e dedikuara të ketë vrojtuesit e vet.

Kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve :Z.Gjekaj në emër të grupit politik PS shprehet pro miratimit të pr/aktit, edhe Z.Sokoli Pro, Znj.Shala Kundër dhe Z.Gjylbegaj është dakort me pr/vendimin.

Hidhet në votim Pr/akti nr.2, ku rezultojnë 29vota Pro, 10 Kundër, 1 Abstenim.

Miratohet

Hidhet në votim Pr/akti nr.3, ku rezultojnë 40 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pr/vendin nr.4 dhe 5. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të Këshilltarit bashkiak Z. Gjovalin Darragjati”*

Pr/ Vendim: *“Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të Këshilltarit bashkiak Z. Helga Sallaku”*

Relaton në emër të komisionit të mandateve Znj.Gjekaj sipas materialit të përgatitur.

Hidhet në votim Pr/akti nr.4, ku rezultojnë 39vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Hidhet në votim Pr/akti nr.5, ku rezultojnë 39vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 6. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për një ndryshim të pjesshëm të VKB nr.51 datë 14.04.2009 “Miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër”, miratuar me VKM nr.421 datë 02.06.2010, të ndryshuar sipas lidhjes 1, të pronës me numër rendor 126, sipas formularit për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”.*

Relaton mbi këtë pr/vendim Znj.Leqejza, drejtore e dr.Juridike në Bashkinë Shkodër. Znj.Gjekaj kërkon fjalën dhe thotë se komisionit të ligjeve i është dashur më shumë kohë për ta studiuar këtë pr/vendim dhe kemi dalë me një relacion për këtë. Ajo relaton shkurtimisht sipas materialit të përgatitur. Nga ana e komisionit të buxhetit nuk ka relacion. Nga ana e këshilltarëve Z.Sokoli pyet se sa do jetë e mundur që kjo zonë, të kthehet në shërbim të familjeve me banesa sociale?

Znj.Leqejza përgjigjet se prona në fjalë është në pronësi të Bashkisë Shkodër dhe do kthehet në banesa sociale, por më parë duhen kryer procedura të caktuara ligjore, prandaj dalim me këtë pr/vendim në Këshill.

Z.Bjanku shprehet se zona në fjalë është zonë industriale dhe po flitet për një ndryshim destinacioni nga ish-kombinati i drurit në banesa sociale. Ai mendon se ndryshimet në zhvillimin urban të qytetit të bëhen më të mirëstudiara.

Z.Bejleri sqaron se zona aty e ka humbur tashmë identitetin e vet dhe ka kohë që është kthyer në zonë urbane/banimi prandaj nuk mund ta quajmë më zonë industriale. Aty

ka madje banesa të legalizuara. Prandaj, kjo besojmë se do shërbejë shumë për banesa për familjet në nevojë.

Z.I.Sokoli mendon se në lidhje me pr/vendimin e propozuar ka mospërputhje përdorimesh prandaj ai thotë se fillimisht duhet të ndyshohet plani dhe madje të kryhen edhe analiza mjedisore, pasi kjo zonë ka qënë e destimuar për industri dhe nuk dihet nëse është e shëndetshme për banesa.

Z.Jona Leqeja shprehet se duke qënë se ajo zonë është përdorur deri tani për fasoneri nuk mendoj që përbën rrezik për banorët.

Po ashtu edhe **Znj.Kavaja** thotë se aty aktualisht është zonë e banuar dhe kjo tregon që nuk ka rrezikshmëritë që pretendohen.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, **Znj.Gjekaj** shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD **Z.Sokoli** po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, edhe **Znj.Shala** për grupin BF dhe **Z.Gjylbegaj** për grupin PD shprehin dakortësi.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 40 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 7. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për miratimin e listës së përfiruesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk e përballojnë qiranë e tregut të lirë për vitin 2024”*

Relaton për pr/vendim **Znj.Kruja**, drejtore, drejtorja e Shërbimit Social, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Sokoli kërkon të dijë se sa është e mundur ndryshimi i çmimit të qirasë meqënëse edhe çmimi i tregut është rritur?

Përgjigjet **Znj.Kruja** dhe thotë se çmimet janë parashikuar tashmë duke patur parasysh çmimet e tregut.

Znj.Shllaku merr fjalën dhe thotë se në një shkresë të ministrisë drejtuar Bashkisë Shkodër thuhet se në programet përfituese sociale duhet të ketë domosdoshmërisht familje të komunitetit Rom-egjiptian, por në listat e paraqitura vërej që nuk ka të tilla. A ka ndonjë arsye pse këto familje nuk janë përfshirë?

Znj.Kruja përsëri përgjigjet se pavarësisht përkatësisë është detyrim ligjor që të plotësohet dokumentacioni përkatës për të qënë përfitues. Në këtë rast nuk ka patur familje të këtij komuniteti dhe janë informuar për këtë.

Znj.Leqeja kërkon të dijë se sa % e fondit është arritur të përmbushet me aplikues dhe a është e mundur të rritet aksesueshmëria e aplikimit për strehim social duke e mundur aplikimin edhe në qendrat komunitare?

Përgjigjet **Znj.Kruja** dhe thotë se nga 62 përfitues që kemi patur, kemi 54 të tillë. Po punohet gjithashtu edhe për të kryer aplikimet pranë qendrave komunitare por duhet domosdoshmërisht që dorëzimi i dokumentave të bëhet tek zyrat me një ndalesë në Bashki.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, **Znj.Gjekaj** shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD **Z.Sokoli** po ashtu shprehet dakort

miratimit të Pr.vendimit, edhe Znj.Shala për grupin BF dhe Z.Gjylbegaj për grupin PD shprehin dakortësi.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 37 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 8: Pr/ Vendim: *“Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projektin Hold-on Nxitja e aneksit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë”*

Relaton përsëri për pr/vendimin **Znj.Kruja**, drejtore, drejtoria e Shërbimit Social, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Shala kërkon të dijë nëse Bashkia Shkodër ka kapacitete njerëzore, profesionale të fushës që do merren me këtë projekt? Dhe si do bëhet përzgjedhja e tyre?

Znj.Kruja shprehet se projekti ka monitues dhe specialistë të fushës dhe përzgjedhja bëhet me procedurat përkatëse.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Znj.Gjekaj shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, edhe Znj.Shala për grupin BF dhe Z.Gjylbegaj për grupin PD shprehin dakortësi.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 37 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën e parë shtesë: Pr/ Vendim: *“Për miratimin në parim të vlerës së bashkëfinancimit dhe listës së përfituesve për realizimin e projektit “Rikonstruksion rrugët FERMENTIM”*

Relaton për këtë pr/vendim **Z.Mema**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Gj.Sokoli përgëzon nismën për këtë pr/vendimin dhe fton kolegët këshilltarë për miratim.

Kryetarët e grupeve shprehin gjithashtu të gjithë dakortësi.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 40 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën e tretë shtesë: Pr/ Vendim: *“Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”*

Relaton për këtë pr/vendim **Z.Ndërveshaj**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 40 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën e fundit shtesë: Pr/ Vendim: *“Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese , të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike”*

Relaton përsëri **Z.Malocaj**, sipas materialit të përgatitur nga administrata. Kryetarët e grupeve shprehin të gjithë dakortësi për këtë pr/vendim.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 40 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjalën e merr **Z.Gjylbegaj**, i cili shprehet se ndryshimet e bëra këto muajt e fundit në planin e mobilitetit, korsitë e biçikletave ose një sens lëvizjeje kanë kërkuar një ngarkesë në trafik. Ne kërkojmë të na vihet në dispozicion një plan strategjik mobiliteti kur mund të jetë gati ky plan duke ditur edhe rëndësinë që ka. Së dyti lidhur me dhënien e oborreve të shkollës në shërbim të komunitetit të zonës në oraret e masdites, në ç'pikë jemi me këtë? Dhe së fundmi lidhur me teatrin, pasi kohët e fundit jemi dëshmitarë që shumë drejtori të rëndësishme janë larguar nga Shkodra, si arkiva, zyra e arsimit etj. A mos ndoshta ky do jetë fati edhe i teatrit? Kërkojmë që të rishikohet ky vendim, që teatri të vazhdojë të jetë krenaria e qytetit.

Znj.Shkrela flet gjithashtu lidhur me çështjen e teatrit dhe kërkon të dijë saktësisht çfarë do ndodh me këtë institucion kaq të rëndësishëm.

Znj.Pode propozon ngritjen e një komisioni vlerësues për godinat në zonën e ish kombinatit të drurit që u diskutua për dhënie për banesa sociale, pasi ajo mendon se gjendja e tyre përbën rrezik për banorët aty.

Znj.Shllaku kërkon të dijë se në ç'pikë jemi me lirimin e hapësirave publike, trotuareve etj. Së dyti dëshiron të dijë se kur do përfundojë korsia e biçikletave në Sarreq.

Përgjigjet **Z.Bejleri** lidhur me teatrin dhe thotë se e ritheksojmë edhe njëherë që përse i përket stafit artistik nuk do ketë asnjë shkrim madje do ketë përmirësim të situatës lidhur me to. Ka patur vetëm një riorganizim të strukturave mbështetëse të disa institucioneve të varësisë të Bashkisë Shkodër. Flasim këtu vetëm për përmirësim dhe rritje efëcence. Ai shton lidhur me planin e mobilitetit, që afati i studimit të tij ka qënë 6 muaj. Në ditët në vazhdim kemi një takim të hapur në lidhje me planin e qytetit, ku ftohen të marrin pjesë të gjithë të interesuarit për të dhënë sugjerimet dhe propozimet e tyre kurse përse i përket hapësirave të shkollave, po përgatiten planet për secilën shkollë, ku çdo shkollë do jetë në dispozicion të komunitetit të zonës përreth. Po ashtu ai përgjigjet edhe për pyetjen e Znj.Shllaku duke thënë se edhe për këtë do merret përgjigje me planin e ri të mobilitetit.

Z.Bjanku kërkon të dijë nëse është e mundur të krijohet një strukturë permanente mirëmbajtjeje për këndet ekzistuese të lojrave të fëmijëve? Po ashtu a mund të merren masa për sigurinë e fëmijëve në shkolla, pasi me ndërhyrjet e fundit në rrugë vërehet se nuk ka asnjë lloj sinjalistike për këtë.

Z.Bejleri bie dakort me shqetësimin dhe sqaron se para pak kohësh Bashkia Shkodër është bërë përfituese e ndërtimit të disa kënde lojrash dhe po shihet mundësia edhe e përmirësimit të kushteve për këndet ekzistuese dhe mirëmbajtjes së tyre. Po ashtu edhe përse i përket sinjalistikës, rrugët në fjalë nuk janë përfunduar akoma por patjetër që do ketë vëmendje të shtuar për sinjalistikën aty.

Znj.Bajraktari kërkon të dijë se sa është numri i punonjësve të prekur nga shkrirja e institucioneve të varësisë dhe a janë informuar ato për këto ndryshime? Pyetje tjetër e saj është se çfarë do ndodh me punonjësit e tjerë a do transeferohen në total apo do kenë kontrata individuale në institucione tjera?

Z.Luli përgjigjet se në VKB nr.54 dt.29.12.2023 thuhet në njërin nga pikat që Bashkia duhet të merret me çdo procedurë konform ligjit. Pra të gjitha përgjigjet i gjeni në këtë VKB.

Z.I.Sokoli shpreh shqetësimin e tij lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm, kjo sipas tij vjen nga keq menaxhimi i UKSH-së. Ai i bën thirrje kryetarit të bashkisë që duhet të marri masa për të mos patur probleme të tilla, pasi zona të rëndësishme të qytetit nuk kanë ujë dhe drejtori i kësaj ndërmarrjeje nuk përgjigjet për këtë.

Znj.Shkrela shpreh një tjetër shqetësim të banorëve të Postribës lidhur me ujin e pijshëm, që vjen i ndotur nga dy gurorë që punojnë aty. Pavarësisht se kërkesat e tyre kanë qënë të shumta, situata nuk ka gjetur zgjidhje. Shpresojmë shumë që të merren masa për zgjidhjen e këtij problemi. Tjetër shqetësim i kësaj njësie administrative ka lidhje me një rrugë që lidh dy fshatra aty, ato kërkojnë ndërhyrje në të dhe besoj që kjo duhet patur si prioritet. Edhe në fshin Bleran, Bardhaj banorët kërkojnë pastrin e dy kanaleve dhe kërkojnë që Bashkia të marr masa, pasi uji i tyre shkakton dëme të shumta.

Z.Bejleri sqaron se në lidhje me rrugën e Dragoçit, aty ka shkuar grupi i punës dhe po punohet për projektin dhe preventivin e saj.

Z.Behri shpreh shqetësimin e banorëve të rrugës Et'hem Kazazi, të cilët kërkojnë vendosjen e sinjalistikës pasi ndjehen të rrezikuar.

Përgjigjet **Z.Bejleri** dhe thotë që kjo rrugë është investim i ri dhe patjetër që edhe sinjalistika do jetë e standarteve të kërkuara.

Znj.Shala kërkon që të merren masa për ndërtesat pas ish Kafes së Madhe, të cilat janë shqetësim për banorët aty, pasi janë kthyer në Ëc publike. Kërkohet ndërhyrje.

Z.Bejleri shprehet se shqetësimi është i drejtë, por një pjesë e këtyre ndërtesave janë private dhe ndërhyrja bëhet e vështirë, megjithatë do shihet mundësia e të paktën bllokimit provizor të hyrjeve.

Z.Pashuku po ashtu pyet nëse janë informuar punonjësit që preken nga ristrukturimi i institucioneve të varësisë?

Z.Sokoli thotë se tjetër shqetësim vijon të jetë qendra shëndetësore nr.2, tek ish Konvikti S.Spahiu, që akoma nuk ka marr zgjidhje. Kërkohen marrje masash urgjente.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, Kryetari i Këshillit e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 31.1.2024. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 9 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Zbardh procesverbalin

Irma Sulishti

Sekretar

Denis LESH



KRYETAR

Olion LULI

